- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____**Vula**

Shënim:Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit /entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj: **Bashkengjitur DST ne SPE**

Specifikimi i Materialeve: **Bashkengjitur DST ne SPE**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: **Bashkengjitur DST ne SPE**

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve:

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3. Afati i realizimit</i>				
Nr	Përshkrimi i Punëve	Java 1/Muaji 1	Java 2/Muaji 2	Java 3/Muaji 3	Java 4/Muaji 4	Java 5/Muaji 5
1.						
2.						
3.						
4						

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Bashkengjitur DST ne SPE

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. *Formularin e ofertes sipas Shtojcës 1;*
- d. *Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit sipas Shtojcës 2;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (regjistrat tregtarë, sipas nenit 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së) dhe të kete në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (2018, 2019, 2020), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqerohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2018, 2019, 2020) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Punë të ngjashme, për një kontratë të vetme, në një vlerë, jo më të vogël se 50% të vlerës së fondit limit të përlogaritur nga Enti/Autoriteti Kontraktor, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, llogaritur nga data e hapjes së procedurës së prokurimit publik,

Ose

Punë të ngjashme, ku vlera totale e punëve të ngjashme, të marra së bashku, gjatë tre viteve të fundit, llogaritur nga data e hapjes së procedurës së prokurimit publik, të jetë në një vlerë jo më e vogël se 200% e vlerës së fondit limit që prokurohet, të përlogaritur nga Enti/Autoriteti Kontraktor.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura, e bën ofertën të kualifikueshme. Për të vërtetuar dhe provuar përvojën e mëparshme, të suksesshme në ekzekutimin e kontratave të ngjashme, Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme: Për kontrata të realizuara me institucione shtetërore duhet të paraqitet kontrata, situacioni përfundimtar, formulari i vlerësimit nga investitori, akt kolaudimi, çertifikata e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore e shitjes. Për kontrata për punë të realizuara me subjekte private të paraqitet i njëjti dokumentacion sa më sipër, shoqëruar edhe me lejen përkatëse ndërtimore.

2. **Operoret ekonomike duhet të disponojnë liçencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Proçedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Shqyrtimi i liçencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara në**

sa më sipër. Liçensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjes:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçencat e mëposhtme:

- a) NP 1/A Punime gërmimi në tokë,
- b) NP 4/A Rrugë, autostrada, mbikalime etj.
- c) NP 7/A Ujësjellësa, gazsjellësa etj.
- d) NS4/A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to etj

Në rastet e mbështetjes në kapacitete të subjekteve të tjera/Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, *secili anëtar i bashkimit duhet t'i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim/kontratën e bashkëpunimit.*

Në rast pjesëmarrjeje të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit, licensën e mësipërme me kategoritë dhe nivelet e përshkruara, duhet ta ketë të njehsuar pranë organeve përkatëse në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit të saj në fuqi.

3. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit publik, Çertifikatat ISO ose ekuivalentin e tyre, në përputhje me objektin e kontratës që prokurohet, si më poshtë:

- ✚ ISO 9001:2015/ose të përditësuar/ekuivalente, për, Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë.
- ✚ ISO 14001:2015/ose të përditësuar/ekuivalente, për, Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit.
- ✚ ISO 45001:2018/ose të përditësuar/ekuivalente, për, Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë.
- ✚ ISO 39001:2012/ose të përditësuar/ekuivalente, për, Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor.

Çertifikatat e mësipërme, kërkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës së prokurimit publik, konform dispozitave ligjore në fuqi. Këto çertifikata, duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe të jenë të vlefshme datën e hapjes së procedurës së prokurimit publik.

4. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të stafit për realizimin dhe zbatimin e punimeve. Numri i punonjësve të siguar, duhet të jetë mesatarisht jo më i vogël se 35 punonjës të siguar për periudhën Janar 2021 – Maj 2021.

Për plotësimin e këtij kriteri, të paraqitet vërtetim nga Administrata Tatimore, në të cilin të jetë i specifikuar numri i punonjësve për çdo muaj, për periudhën e kërkuar, konform parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Së bashku më vërtetimin e mësipërm, të paraqiten në procedurën e prokurimit publik edhe listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas formularit E/SIG-25, për të gjithë periudhën e kërkuar, Janar 2021 – Maj2021.

5 Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues duhet të ketë drejtues teknik në licencën e shoqërisë dhe të jenë të punësuar për periudhën Janar 2021 - Maj 2021, minimalisht Inxhinierët e mëposhtëm:

1(një) Inxhinier Ndertimi/Hidroteknik;

1(një) Inxhinier Elektrik

1(një) Inxhinier Mekanik

Për stafin e mësipërm duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, për të gjithë periudhën e zbatimit të punimeve, diploma, librezë e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të gjithë periudhën e kërkuar.

Në rastet e mbështetjes në kapacitete të subjekteve të tjera/Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, *secili anëtar i bashkimit duhet t'i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim/kontratën e bashkëpunimit.*

6. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga Administratori i shoqërisë, ku të deklarojë se, stafi deklaruar në tender (drejtuesit teknik), nuk do të jenë të angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jenë në dispozicion të këtij objekti deri në përfundimin e punimeve.

Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë pjesë të stafit të tij, të cilët duhet të figurojnë në list pagesën e shoqërisë ofertuese, për të gjithë periudhën e kërkuar, të paktën: - 1 Inxhinier Hidroteknik,

- 1 Inxhinier Elektrik,

- 1 Inxhinier Gjeolog.

- 1 Inxhinier Topograf

Për plotësimin e këtij kriteri, duhet të paraqiten në procedurën e prokurimit publik, kontratat e punës, librezë pune, diploma që provon kërkesat e mësipërme, si dhe Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas formularit E/Sig-25, për të gjithë peiudhën e kërkuar, të punësuar me kodet përkatëse të punësimit.

7. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë pjesë në stafin e tij, të cilët duhet të figurojnë në list pagesën e shoqërisë, për të gjithë periudhën e kërkuar, të paktën:

- 1(një) inxhinier ndërtimi të çertifikuar për sistemin e menaxhimit të cilësisë së punimeve, sipas standartit ISO 9001:2015.
- 1(një) inxhinier të çertifikuar për sistemin e menaxhimit të mjedisit, sipas standartit ISO 14001:2015.
- 3(tre) inxhinierë të çertifikuar për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.

Për plotësimin e këtij kriteri duhet të paraqitet Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune si dhe çertifikata/dokumenti që provon çertifikimin e mësipërm, si dhe Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore, sipas formularit E/Sig-25, për të gjithë periudhën e kërkuar.

8. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë staf mbështetës për realizimin e objektit të prokurimit, të paktën një inxhinier mjedisi, në profilin trajtim uji, të çertifikuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Për plotësimin e këtij kriteri, duhet të paraqiten në procedurën e prokurimit publik kontrata e punës/shërbimit, diploma, si dhe çertifikatën që provon çertifikimin e mësipërm, dokument ky i lëshuar nga Institucione Shtetërore, të autorizuara me ligj.

9. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë në procedurën e prokurimit publik, deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë ofertuese, që, autorizon Entin/Autoritetin Kontraktor, të bëjë verifikimet përkatëse mbi të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur në procedurën e prokurimit publik, pranë çdo institucioni/organi/kompanie që i ka lëshuar ato, në rast se do të lindin dyshime mbi vërtetësinë e tyre.

10. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë pjesë të stafit të tij, të cilët duhet të figurojnë në list pagesën e shoqërisë ofertuese, për të gjithë periudhën e kërkuar, të paktën:

- 1 teknik ndërtimi,
- 1 elektrikist,
- 1 drejtues të makinave të rënda me ngritëse,
- 1 hidraulik,
- 1 hekurkthyes,
- 1 karpentier,
- 1 murator për konstruksione.

Për plotësimin e këtij kriteri, duhet të paraqiten në procedurën e prokurimit publik, kontratat e punës, librezë pune, si dhe çertifikata /dokumenti që provon kërkesat e mësipërme, si dhe Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas formularit E/Sig-25, për të gjithë periudhën e kërkuar, të punësuar me kodet përkatëse të punësimit.

- 11. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë pjesë të stafit të tij, i cili duhet të figurojë në list pagesën e shoqërisë ofertuese, për të gjithë periudhën e kërkuar, të paktën 1 Inxhinier Hidroteknik të çertifikuar për shërbimet për, sigurinë dhe shëndetin mjedisor në ujësjellësa, lëshuar nga institucione shtetërore/kompani ndërkombëtare të kësaj fushe.**

Për plotësimin e këtij kriteri, duhet të paraqiten në procedurën e prokurimit publik, kontrata e punës, librezë pune, diploma që provon kërkesat e mësipërme, si dhe Listepagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas formularit E/Sig-25, për të gjithë periudhën e kërkuar, të punësuar me kodin përkatës të punësimit.

- 12. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë staf mbështetës ose të kontraktuar me kontrate pune/shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit, të paktën një inxhinier mjedisi, në profilin trajtim uji, të çertifikuar për efektet dhe metodat e vlerësimit mjedisor, si dhe problemet mjedisore.**

Për plotësimin e këtij kriteri duhet të paraqiten kontrata e punës/shërbimit, diploma, si dhe certifikatën që provon çertifikimin e mësipërm, dokument ky i lëshuar nga Institucione Shtetërore, të autorizuara me ligj.

- 13. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të paktën një Inxhinier në Gjeoteknikë, të çertifikuar për teknologjitë e reja në gjeoteknikë, lëshuar nga Institucione Shtetërore/Organe Kompetente, për të cilin duhet të paraqitet në procedurën e prokurimit publik diploma, certifikata/dokumenti që provon çertifikimin e mësipërm, kontrata e punës, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë, me kodin përkatës të punësimit, për të gjithë periudhën e kërkuar.**

- 14. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë pjesë të stafit, i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë, të paktën një person të kualifikuar, të çertifikuar për prishjen e shtresave të betonit, për tubat e çelikut, për tubat PE, shtresën e asfaltobetonit, për gërmimet në kanale, për muraturën e tullës, lidhur me punimet në ujësjellësa, për të cilin duhet të paraqiten në procedurën e prokurimit publik kontrata e punës e vlefshme, dokumenti që provon çertifikimin e mësipërm, si dhe duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë.**

- 15. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë pjesë të stafit, i cili duhet të figurojë në listepagesat e shoqërisë, të paktën një inxhinier ndërtimi të çertifikuar për zbatimin e punimeve në realizimin e ujësjellësave për punimet e gërmimit, muraturës, shtresën e asfaltobetonit, për të cilin duhet të paraqitet në procedurën e prokurimit publik kontrata e punës e vlefshme, dokumenti që provon çertifikimin e mësipërm, si dhe duhet të figurojë në listepagesat e shoqërisë.**

- 16. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë në procedurën e prokurimit publik, një deklaratë më shkrim nga administratori i shoqërisë ofertuese, lidhur me personin përgjegjës, Inxhinier Ndërtimi/Hidroteknik/Mekanik që do të bëjë**

edhe ndjekjen e punimeve, për të cilin të paraqiten në procedurën e prokurimit publik deklarata, kontrata e punës, si dhe diploma.

17. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të disponojë në pronësi ose me qira, minimalisht mjetet e pajisjet e mëposhtme:

- a. Kamion me vinç, copë 1, me kapacitet mbajtës 3 – 3.5 ton. *Për plotësimin e këtij kriteri, duhet të paraqitet çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, siguracioni, foto dhe kontrolli teknik i mjetit.*
- b. Eskavatorë me goma, 3 copë. Për plotësimin e këtij kriteri të paraqitet çertifikata e pronësisë; leja e qarkullimit; çertifikata e kontrollit teknik; siguracioni; dhe foto përkatëse të mjeteve.
- c. Minieskavator bobcat (ose ekuivalent), 2 copë. Për plotësimin e këtij kriteri të paraqitet dokumentacion që të provojë pronësinë e mjeteve si kontrata, ose akt çdoganimit, ose fatura tatimore përkatëse, ose çdo dokument që provon pronësinë e tyre, si dhe foto përkatëse të mjeteve.
- d. Kamion vetëshkarkues, copë 1, me kapacitet mbajtës 19 – 20 ton. Për plotësimin e këtij kriteri, duhet të paraqitet çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, siguracioni, foto dhe kontrolli teknik i mjetit.
- e. Autobot uji, copë 1. Për plotësimin e këtij kriteri, duhet të paraqitet çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, siguracioni, foto dhe kontrolli teknik i mjetit.
- f. Depozitë uji, 5000 lit, copë 1. Për plotësimin e këtij kriteri të paraqitet dokumentacion që të provojë pronësinë e tyre, fatura tatimore përkatëse, ose çdo dokument që provon pronësinë e tyre.
- g. Autobetoniere, 1 copë. Për plotësimin e këtij kriteri, duhet të paraqitet çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, siguracioni, foto dhe kontrolli teknik i mjetit.
- h. Autopompë betoni, 1 copë. Për plotësimin e këtij kriteri, duhet të paraqitet çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, siguracioni, foto dhe kontrolli teknik i mjetit.
- i. Asfaltshtruese, 1 copë. Për plotësimin e këtij kriteri të paraqitet dokumentacion që të provojë pronësinë e tyre, fatura tatimore përkatëse, ose çdo dokument që provon pronësinë e tyre.
- j. Rrul ngjeshës, 1 copë. Për plotësimin e këtij kriteri të paraqitet dokumentacion që të provojë pronësinë e tyre, fatura tatimore përkatëse, ose çdo dokument që provon pronësinë e tyre.
- k. Betoniere elektrike 4 copë. Për plotësimin e këtij kriteri të paraqitet dokumentacion që të provojë pronësinë e tyre, fatura tatimore përkatëse, ose çdo dokument që provon pronësinë e tyre.
- l. Pajisje për matjen e presionit, 1 copë: e përbërë nga pompa automatike e presionit, sensor për matjen e temperaturës, sensor për matjen e presionit, ekranin, printerin. Parametrat minimal: Kapaciteti i prurjes, 28l/min – 68lit/min, prurja e energjisë elektrike 230v – 50Hz ose 400v – 50 HZ, valvul sigurie, presioni maksimal 25 bar, komandimi të jetë automatik/manual, memorie 1 milion matje, temperatura e matjes nga -10 deri në 45 C. Të jetë sipas standartit EN 805, gjenerimi i presionit të kërkuar të jetë në më pak se 10 minuta, të ketë saktësi shumë të lartë të matjes dhe rezolucionit të ekranit. Për plotësimin e këtij kriteri të paraqitet dokumentacion që të provojë pronësinë e tyre, fatura tatimore përkatëse, ose çdo dokument/akt çdoganimit që provon pronësinë e tyre.
- m. Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-6 Ton, 1 copë. Për plotësimin e këtij kriteri, duhet të paraqitet çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, siguracioni, foto dhe kontrolli teknik i mjetit.
- n. Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3-3.5 Ton, 1 copë. Për plotësimin e këtij kriteri, duhet të paraqitet çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, siguracioni, foto dhe kontrolli teknik i mjetit.

- o. Aparaturë për testimin e ngjeshmërisë së materialit me metodë me goditje, ku forca e goditjes (ndikimit) të jetë 7070N, koha e ndikimit 17ms, lartësia e lëshimit 720mm, me memorie 900 matje, 1 copë. Për plotësimin e këtij kriteri të paraqitet dokumentacion që të provojë pronësinë e tyre, fatura tatimore përkatëse, ose çdo dokument/akt çdoganim që provon pronësinë e tyre.
- p. Eskavator me zinxhirë, 2 copë. Për plotësimin e këtij kriteri të paraqitet dokumentacion që të provojë pronësinë e tyre, fatura tatimore përkatëse, ose çdo dokument/akt çdoganim që provon pronësinë e tyre.
- q. Makineri për ngjitje tubash, 1 copë. Për plotësimin e këtij kriteri të paraqitet dokumentacion që të provojë pronësinë e tyre, fatura tatimore përkatëse, ose çdo dokument/akt çdoganim që provon pronësinë e tyre.
- r. Vibrator 2 copë. Për plotësimin e këtij kriteri të paraqitet dokumentacion që të provojë pronësinë e tyre, fatura tatimore përkatëse, ose çdo dokument/akt çdoganim që provon pronësinë e tyre.
- s. Trapan, 1 copë. Për plotësimin e këtij kriteri të paraqitet dokumentacion që të provojë pronësinë e tyre, fatura tatimore përkatëse, ose çdo dokument/akt çdoganim që provon pronësinë e tyre.

- t. Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt, minimumi 5 copë. Për plotësimin e këtij kriteri të paraqitet dokumentacion që të provojë pronësinë e tyre, fatura tatimore përkatëse, ose çdo dokument/akt çdoganim që provon pronësinë e tyre.
- u. Kokore pune, 35 copë. Për plotësimin e këtij kriteri të paraqitet dokumentacion që të provojë pronësinë e tyre, fatura tatimore përkatëse, ose çdo dokument që provon pronësinë e tyre.
- v. Kutitë e ndihmës së shpejtë, 5 copë. Për plotësimin e këtij kriteri të paraqitet dokumentacion që të provojë pronësinë e tyre, fatura tatimore përkatëse, ose çdo dokument që provon pronësinë e tyre.
- w. Jelek pune, 35 copë. Për plotësimin e këtij kriteri të paraqitet dokumentacion që të provojë pronësinë e tyre, fatura tatimore përkatëse, ose çdo dokument që provon pronësinë e tyre.

Për mjetet/pajisjet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë noteriale ku të jetë përcaktuar objekti konkret i prokurimit, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve, deri në përfundimin e plotë të punimeve.

18. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë në procedurën e prokurimit publik një deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë ofertuese, ku të deklarojë se, makineritë e kërkuara, nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera, si dhe do të jenë në dispozicion të këtij objekti, deri në përfundimin e plotë të punimeve.

19. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë në tender një deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë, ku të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik, si dhe të deklarojë se do të paraqesë me shpenzimet e veta të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara në dokumentet e tenderit, pranë Entit/Autoritetit Kontraktor, në rast se do të lindi nevoja për verifikimin e tyre, përpara shpalljes së klasifikimit

- 20. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, së bashku me grafikun e punimeve dhe preventivin, duhet të dorëzojë edhe analizat teknike për zërat e preventivit. Mosparaqitja në formën e kërkuar, përbën kusht për skualifikim, konform parashikimeve ligjore e nënligjore në fuqi.**
- 21. Kandidatët/Operatorët Ekonomikë Ofertues duhet të dorëzojë për te gjithë mallrat Hidraulike objekt prokurimi Autorizim Prodhuesi ose Distributori në rast se do të paraqitet Autorizim Distributori operatori ekonomik ta vertetoj këte duke paraqitur kontratë premtimi, letër angazhimi / akt-marreveshje lidhur mes Kompanisë prodhuese dhe Distributorit të autorizuar Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.**
- 22. Kandidatët/Operatorët Ekonomikë Ofertues, të interesuar për këtë procedurë prokurimi publik, duhet të paraqiten më datë 21.06.2021, ora 12:00 pranë Ujësjiellës Kanalizme Sh,a, Durrës, për të bërë një vizitë në terren, së bashku me stafin teknik të U.K.Durrës, me qëllim njohjen e kushteve të ekzekutimit në terren të objektit. Kandidati/Operatori Ekonomik i interesuar, duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës, do tu jepen informacione shtesë dhe shpjegime për të gjithë objektin.**
- 23. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë në tender deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë që, autorizon autoritetin kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse mbi të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur në tender, në rast se do të lindin dyshime mbi vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur.**
- 24. Në të gjitha rastet kur është përdorur fjala markë ose emër, njihet njëvlefshmëria/barazvlefshmëria ose ekuivalent.**

Mos paraqitja e deklaratave në formën dhe mënyrën e kërkuar, përbën shkak për skualifikim. Dhënia e informacionit të rremë, përbën shkak për penalizim.

Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën Shqipe, si gjuhë e ofertës, të bëjnë noterizimet përkatëse, si dhe të jenë të çertifikuara "Apostile". Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 05 Tetor 1961 "Për heqjen e kërkesës për legalizimin diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja", duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

1. Afati i përfundimit të punimeve të jetë 60 dite kalendarike sipas grafikut të punimeve të hartuar nga projektuesi.

Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë:

- Kopje të çertifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qëndrore të Faturave.
- Kopje të çertifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me shoqërinë e Çertifikuar për zgjidhjen software-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes Softwar-ike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Punët/ pajisjet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet, mbi kapacitetin e, të cilave do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: <hr/> <hr/> etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]]

<p>të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
---	--

B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

--

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;	Po []
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po []
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po []
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	Po []
5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që: a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor; b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .	Po []
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	Po [] Jo []
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).	Po [] Jo []
8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim,	Po [] Jo []

<p>kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</p> <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p>	
<p>9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose kërkesat specifike të punëve shërbimeve/apo pajisjeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.</p>	<p>Po [] Jo []</p>

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

<p>Deklarata</p>
